



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punimjet/Prodato Received/Delivery	13.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPJESHCK	5376/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.721/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional-në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.45/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 30.06.2022, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.721/2019 të datës 20.11.2019 parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër institucionit punëdhënës
Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 13.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.721/2019 e datës 20.11.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET ne fuqi Njoftimi për kandidatin e suksesshëm për pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit" në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren i datës 25.09.2019.

A r s y e t i m

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren sipas autorizimit të datës 22.08.2019 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, me datë 28.08.2019 ka shpallur konkursin për pozitën e punës: "Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit" në të cilin sipas shkresave të lëndës rezultoi që ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo i njëjti nuk është shpallur kandidatë i suksesshëm.

Ankuesi kundër njoftimit të datës 25.09.2019 për kandidatin e suksesshëm ka parashtruar ankesë me datë 21.10.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, ndërsa ankuesit Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren me datë 14.11.2019 i ka kthyer shkresën përmes të cilës e ka njoftuar se ankuesi mund të parashtroj ankesës drejtpërdrejtë në Këshill sipas dispozitave ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik

Ankuesi sipas udhëzimit në mjetet juridike me datë 20.11.2019 ka parashtruar ankesë në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 25.11.2019 e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren. Më datë 06.12.2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 16.12.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 30.06.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.45/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të datës 16.12.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 20.11.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr.45/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 30.06.2022, Ankesa e ankuesit e datës 20.11.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Këshillit me numër:237/2018 i datës 14.09.2022; Vendimin me numër protokolli:03-135 të Sekretarit të përgjithshëm të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren i datës 02.07.2019; Konkursin e datës 28.08.2019; Njoftimin për listë të ngushtë i datës 18.09.2019; Opinionin ligjor të datës 08.11.2019; Njoftimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve e dhe të Ankesave datës 14.11.2019; Formularin e Vlerësimit individual të kandidatit të suksesshëm Form MAP-SHCK-08a; Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm për themelimin e komisionit të rekrutimit i datës 12.09.2019; Shkresë e evidentuar me numër -12-; E-mailin e datës 18.09.2019 dërguar S.K për ankuesin; E-mailin datës 18.09.2019; Kërkesën për qasje në dokumente e datës 27.09.2019; Njoftimin e datës 20.09.2019 për mbajtjen e intervistës me gojë; Shkresa e evidentuar me numër -15-; Akt emërimit e datës 21.01.2013; kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 25.11.2019; Përgjigja në kërkesë e datës 02.12.2019; Autorizimin e DASHC/MAP i datës 22.08.2019; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës

22.01.2019 për anëtarin H.H; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 22.01.2019 për anëtarin H.H; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 22.01.2019 për anëtarin D.K; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 09.10.2017; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Njoffimin për listën e ngushtë i datës 18.09.2019; Kërkesa për punësim e kandidatit A.S e datës 10.09.2019 me dokumentet e bashkangjitura si në vijim: Diplomën e datës 22.04.2008 me numër:517; Kopjen e letërnjoftimit; Ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile i datës 10.09.2019; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren e datës 11.09.2019; Akt emërimit e datës 01.01.2012; Vendimin e Kryetari të Komunës së Prizrenit i datës 01.01.2012; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 20.06.2016; Çertifikatën e datës 07.04.2008; Vërtetimin e datës 13.07.2009; Çertifikatën e datës 08.03.2013; Çertifikatën e periudhës nëntor/dhjetor 2015; Çertifikatën themelore profesionale për prokurim e kandidatit A.S; Çertifikatën me shifrën 27/2011; Çertifikatën e datës 08.03.2013; Çertifikatën e datës 27.04.2018; Çertifikatën 01.11.2006; Çertifikatën e datës 08.05.2009; Çertifikatën e lëshuar nga USAID dhe BSC; Çertifikatën me shifrën 2014-2016; Kërkesën për punësim e datës 10.09.2019 për kandidatin Kopjen e letërnjoftimit të kandidatit G.G; Çertifikatën e lindjes së datës 10.09.2019; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren e datës 10.09.2019; Vërtetimin e marrëdhënies së punës i datës 07.05.2019; Diplomën e datës 17.01.2011 me numër:2456; Çertifikatën themelore profesionale të prokurimit të kandidatit G.G me numër:162; Kërkesa për punësim e kandidatit e datës 04.09.2019 me dokumentet e bashkangjitura si në vijim: Vërtetimin e lëshuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren i datës 28.05.2019; Diplomën e datës 15.01.2014 me numër:026/0114, Vendimin e Sekretari të Përgjithshëm i datës 02.07.2022; Akt emërimit e datës 25.09.2018; Vendimin për kryerjen e punëve shtesë i datës 30.10.2018; Vërtetimin e datës 17.07.2018; vërtetimin e datës 03.09.2018; referencën e datës 05.08.2013; Çertifikatën e datës 23.08.2019; Vërtetimin e datës 06.09.2019 lëshuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren; Çertifikatën themelore profesionale për prokurim të kandidatit E.K me numër:108; Vërtetimin e kopjes së dokumentit origjinal me shenjën LRP nr.5674/2018; Kopjen e letërnjoftimit të E.K; Ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile e datës 02.08.2019; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore Prizren-Dega Suharekë e datës 02.08.2019; Çertifikatë e datës 11.10.2017; Çertifikatën e datës 02.03.2015; Çertifikatën e datës 15.04.2004; Çertifikatën e lëshuar nga FLSA LL.C; Çertifikatën datës 13-16 tetor 2017; Çertifikatën e datës 23-23 qershor 2017; Çertifikatën e datës 31 mars 2016; Çertifikatën e datës 23.09.2017; Kontratën e punës e datës 02.05.2013; CV-ja e kandidatit E.K; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 22.12.2017; Formularin e vlerësimit të rezultateve i datës 04.01.2019; Kërkesën për punësim të datës 02.09.2019 e kandidatit me dokumentacionin e bashkangjitur si në vijim: Diplomën e datës 06.12.1984 me numër:3288; Çertifikatën themelore profesionale për prokurim e kandidatit me numër:060; Çertifikatën themelore profesionale për prokurim e kandidatit me numër:065; Çertifikatën themelore profesionale për prokurim e kandidatit me numër:063; Çertifikatën themelore profesionale për prokurim e kandidatit valide deri ne vitin 2009 (numri i palexueshëm); Çertifikatën e datës 17.05.2016; Çertifikatën e datës 18.01.2005; Çertifikatën e datës 18.02.2005; Ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile e datës 02.09.2019; Kopjen e letërnjoftimit të B.K; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore Prizren e datës 02.08.2019; CV e kandidatit B.K; Kontratën e punës me numër:11/2010; Akt emërimit e datës 01.02.2011; Vërtetimin e datës 20.07.2018; Kontratën e punës 29.12.2008; Shkresën e datës 24.03.2004; E-mailin e datës 18.09.2019; E-mailin e datës 20.09.2019; Raportin për përfshirje në listën e ngushtë të datës

18.09.2019; Formularët Form MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Formularët Form. MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularët Form. MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularët Form. MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formulari Form. MAP-SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Njoftimi për kandidatit e suksesshëm i datës 25.09.2019; Testi me shkrim i ankuesit i datës 20.09.2019; Testin me shkrim të kandidatit të suksesshëm i datës 20.09.2019; testin me shkrim i datës 20.09.2019 të kandidatit G.G; E-mailin e datës 01.10.2019; Aktgjykimin A.nr.45/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 30.06.2022; Njoftimin e Këshillit të datës 06.12.2019; E-mailin e datës 07.09.2022 dërguar nga Këshilli për [] E-mailin e datës 09.09.2022 dërguar nga Këshilli për Sekretarin e Përgjithshëm të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [] është e pabazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se në konkursin e shpallur me datë 28.08.2019 nga Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren për pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit" kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diplomë Universitare në fushat e Ekonomisë ose Juridikut;*
- *Pesë (5) vite përvojë pune profesionale, dhe*
- *I Çertifikuar në lëmin e prokurimit publik.*

Në bazë të shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ka konstatuar se sipas raportit për përfshirjen në listën e ngushtë të datës 18.09.2019 për pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit" kanë aplikuar gjashtë (6) kandidatë, kurse sipas njoftimit të datës 18.09.2019 vetëm katër (4) prej tyre i kanë plotësuar kriteret e konkursit si vijon:

[] dhe [] ndërsa sipas njoftimit të datës 25.09.2019 rezulton se kandidati i suksesshëm që ka arritur pikë më shumë se të tjerët është []

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dosjet e ankuesve dhe në bazë të provave të administruara ka gjetur se kandidati posedon Diplomën e datës 22.04.2008 me numër:517 sipas së cilës dëshmohet se me datë 04.04.2008 i ka përfunduar studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa sipas Aktit të emërimit të datës 01.01.2012 është në marrëdhënie pune me afat të pacaktuar-karrierës, ndërsa posedon edhe Çertifikatën themelore profesionale të prokurimit me numër:018, po ashtu kandidati [] posedon Diplomën e datës 17.01.2017 me numër:2456 sipas së cilës dëshmohet se me datë 10.02.2006 i ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa sipas vërtetimit të punës i datës 07.05.2019 dëshmohet se ka qenë në marrëdhënie pune dhe ka mbi dymbëdhjetë (12) vite, ndërsa posedon edhe Çertifikatën themelore profesionale të prokurimit me numër:162, po ashtu kandidati [] posedon Diplomën e datës 15.01.2014 me numër:026/0114 sipas së cilës dëshmohet se me datë 05.07.2013 i ka përfunduar studimet në Kolegjin Fama, ndërsa sipas vërtetimit të datës 28.05.2019 të lëshuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren si

dhe vërtetimit e datës 03.09.2019 të lëshuar nga NTSH "Toka Jonë" dëshmohet se ka qenë në marrëdhënie pune dhe ka mbi pesë (5) vite përvojë të punës deri në momenti e aplikimit, ndërsa posedon edhe Çertifikatën themelore profesionale të prokurimit me numër:108; po ashtu kandidati Bajram Kolgeci posedon Diplomën e datës 06.12.1984 me numër:3228 sipas së cilës dëshmohet se me datë 10.05.1984 i ka përfunduar studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa sipas Akt emërimit të datës 11.02.2011 të lëshuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, vërtetimit e datës 20.07.2011 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës si dhe vërtetimin e datës 21.05.2015 të lëshuar nga IGK Ballkan dëshmohet se ka mbi njëzet (20) vite përvojë të punës deri në momenti e aplikimit, ndërsa posedon edhe Çertifikatën themelore profesionale të prokurimit me numër:060; andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përfshirjes në listën e shkurt të ankuesit, kandidatit të suksesshëm si dhe të dy kandidatëve të tjerë ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili ka përcaktuar se: *"1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë:1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional dhe 1.2. përvoja e punës"*, pasi që të gjithë kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë i kanë plotësuar kriteret e konkursit të datës 28.08.2019 dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga administrimi provave të lëndës, ka konstatuar se në testin me shkrim për pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit" të mbajtur me datë 20.09.2019 ankuesi ka arritur të grumbulloi 69.2, ndërsa kandidati i suksesshëm ka arritur të grumbulloi 86.4 pikë si dhe gjatë analizimit të testit me shkrim të ankuesit dhe të kandidatit të suksesshëm nuk është vërejtur ndonjë parregullsi e cila mund ta ketë favorizuar respektivisht dëmtuar ndonjërin nga kandidatët në procedurë rekrutimi dhe me rastin e ftesës për intervistim me gojë komisioni përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil nenit 36 paragrafit 2, i cili përcakton: *"kandidatët të cilët kalojnë me sukses testin me shkrim ose arrijnë të mbledhin 50% të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë në testimin me gojë"*, ndërsa në bazë të raportit Forma-MAP-SHCK-10 të renditjes përfundimtare të kandidatëve kandidati i suksesshëm

nga rezultati i testit me shkrim dhe intervistës me gojë ka qenë kandidati me më së shumti pikë të grumbulluara gjithsejtë 87 pikë, ndërsa ankuesi ka grumbulluar gjithsejtë 77.3 pikë, andaj me rastin e rekomandimit të kandidatit të suksesshëm

Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 40 paragrafi 1 i Rregullores 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i përcakton se: *"Në Shërbimi Civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testin me shkrim dhe me gojë"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit" të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren është zhvilluar në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18 paragrafi 1 i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* si dhe në pajtueshmëri edhe me nenin 11 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet*

në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve" ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, bazuar në këto rrethana dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.721/2019

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren ;
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

